



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR**

Procesverbal Nr. 10
nga mbledhja e mbajtur më **9.5.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 12,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli kryetar i Komisionit, Berat Luzha, Selvie Halimi, Hestet Cakolli , Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi. Zef Morina, Zylfi Merxha, Ibrahim Selmani.

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë : përfaqësuesi nga Asoc. i Komunave z. Lamaj, nga MMPH Muhamet Aliu.

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Projektligji për Shitjen e Banesave...,
3. Projektligji për Ushqimin,
4. Të ndryshme

Procesverbali nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi Lulzim Zeneli përshëndeti anëtarët e komisionit duke i pyetur për vërejtjet rreth dy procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluara, por meqenëse nuk janë dorëzuar

vërejtjet me shkrim, procesverbalet u miratuan duke theksuar kryesuesi se ende mund të dorëzohen vërejtjet eventuale me shkrim.

Projektligji për Shitjen e Banesave

Lulzim Zeneli lidhur me këtë projektligj theksoi se GP ka pasur takimin paraprak dhe kërkoi sqarimin rreth nenit 21 ashtu si është kërkuar nga komisioni.

Selvie Halimi njoftoi komisionin se drafti i kompletuar nga MMPH është më i favorshëm si dhe për dakordimin e GP rreth nenit 21 e cila riformulohet si vijon :

Neni 20 (në projektligjin ekzistues Neni 21) :

“Çmimi i garazhit caktohet në mënyrën e përcaktuar sipas nenit 17 paragrafi 1 të këtij ligji, por blerësi nuk ka të drejtë në lirime dhe duhet të paguaj shumën e çmimit të garazhit sipas nenit 21.”

Kryesuesi **Lulzim Zeneli** kërkoi nga komisioni të votohet , me q’rast komisioni votoi për miratimin e punës së GP, me shtesën e miratuar sipas **Muhamet Aliut** i cili kërkoi që të bëhen edhe disa korrektime gjuhësore në variantin e ofruar. Meqenëse **Zef Morina** kërkoi sqarim rreth nenit 18 në variantin e ofruar, sipas së cilës banesat nuk do të shiten por do të falen sipas formulës së ofruar, komisioni e pa të arsyeshme edhe një herë të diskutohet kjo çështje të martën me zyrtarët e MMPH të cilët do të arsyetojnë këtë nen pranë komisionit : a është më mirë të falen shfrytëzuesve të ligjshëm këto banesa (afër 1000 sa janë), me çka edhe do të ikej nga shpenzimet e panevojshme administrative, apo të shiten me çmim tepër të lirë, me çka do të krijoheshin më tepër shpenzime teknike administrative.

Projektligji për Ushqimin

Pasi që stafi njoftoi kryesuesin se zyra e kryeministrit është e angazhuar sot rreth kërkesës së këtij komisioni për agjensionin e ushqimit, por ende nuk ka përgjigje zyrtare, **Lulzim Zeneli** propozoi që kjo pikë të shtyhet për të martën, deri kur shpresohet se do të arrijë përgjigja, me çka komisioni u pajtua.

Të ndryshme

Myrvete Pantina inicioi çështjen e monitorimit të ligjeve nga ana e këtij komisioni dhe propozoi që ligji për monitorim të jetë Ligji për Tokat Bujqësore.

Berat Luzha mendoi se fusha e veprimit të këtij komisioni duhet të zgjerohet duke bashkëpunuar më afërsisht me dy ministritë përkatëse MMPH dhe MBPZHR, sidomos duke u përqendruar edhe në aktivitetin nëpër teren të komisionit.

Lulzim Zeneli u pajtua me propozimet e cekura dhe propozoi aktivitetin më detal të komisionit si vijon :

Elheme Hetemi dhe Myrvete Pantina të angazhohen rreth projektligjeve të sponsoruara nga MBPZHR, sipas radhës është ai për produktet e bimëve dhe të njoftojnë apo të propozojnë komisionit për veprimet që duhen të ndermirën.

Selvie Halimi, Zef Morina dhe Heset Cakolli angazhohen rreth projektligjeve që propozohen nga MMPH.

Selvie Halimi përkrahu një ndarje joformale në komision ku disa anëtarë do të mirën me projektet e MBPZHR, disa me ato të MMPH, pastaj në fund secili të sjellë propozimet e veta personale. Ajo propozoi radhitjen si vijon : projektligji për Mbrojtjen e Mjedisit, VNM, VSM e ashtu me radhë.

Lulzim Zeneli propozoi për të martën përveç “ushqimit” dhe “nenit 18” të Banesave, të shqyrtohet edhe projektligji për mbrojtjen e produkteve të bimëve, ndërsa në procedurë sipas radhës do të pasoi Mbrojtja e Mjedisit etj.

Selvie Halimi tha se edhe raporti mjedisor nga Kastrioti i është dërguar këtij komisionit, e cila duhet të shqyrtohet nga ky komision dhe pastaj të pasojë rekomandimi për ministrinë përkatëse. Lulzim Zeneli u përgjigj se kjo çështje do të ishte ngarkesë për të martën, ndaj mbetet të shqyrtohet të premtën një javë, si propozoi edhe **Blerim Vela**.

Berat Luzha njoftoi komisionin për projektligjin i cili është dërguar Kuvendit rreth plotësimit të ligjit për pyje, për çka edhe ka biseduar me ministrin Idriz Vehapi, në fakt ai ligj tani e tutje do të pësoi ndryshime sa i përket kompetencave. Lulzim Zeneli tha se komisioni do të shqyrtoi këtë çështje me rastin e leximit të parë në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 13,15.

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli